

REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E INDUSTRIJË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË
MINISTARSTVO INDUSTRIJE, PREDUZETNIŠTVA I TRGOVINE
MINISTRY OF INDUSTRY, ENTREPRENEURSHIP AND TRADE

Nr./Br./No. 1963/19
Data/Datum/Datë 18.04.2024
PRISHTINE



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:201330

Datë: 23.11.2023

Numri i dokumentit: 04964278

Ka. nr. 316/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryetar i kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Skender Çoçaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, në çështjen kundërvajtëse ndaj të pandehurit Samir Kurtishaj si pronar i B.I. NTSH. “Edita” me seli në fshatin Greikoc, për shkak të veprës kundërvajtëse nga neni 15 të Ligjit Nr. 08/L-018 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtrishme, neni 19 par. 13, duke vendosur sipas ankesës së të pandehurit Samir Kurtishaj të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr. 904-04/2022, të datës 21.06.2023, në bazë të nenit 55 par. 3 dhe neni 78, konform të nenit 143 par. 1 dhe par. 2 të Ligjit për Kundërvajtje, Nr. 05/L-087, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 23.11.2023, morri këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paraqitur nga i pandehuri Samir Kurtishaj, ndërsa **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr. 904-04/2022, të datës 21.06.2023, si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Nga një kopje të këtij aktgjykimi duhet dorëzuar palëve.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren - Divizioni i Kundërvajtjes, duke vendosur sipas Kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse të ushtruar nga ana e MINT-së, Inspektorati i Tregut, Nr. 19/2022, të datës 27.09.2022, me numër të protokollit Nr. 5812-19-2/1 të datës 27.09.2022, me aktgjykim K. nr. 904-04/2022, të datës 21.06.2023, të pandehurën Samir Kurtishaj si pronar i B.I. NTSH. “Edita” me seli në fshatin Greikoc e ka shpallë përgjegjës:

Sepse më datë 24.09.2022, gjate inspektimit të kryer nga ana e Inspektoratit të Tregut të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në Prishtinë në subjektin ekonomik B. I - NTSH “Edita” me seli në fshatin Greikoc KK Suharekë, lidhur me verifikimin e çmimit maksimal të lejuar për secilin produkt të naftës është konstatuar se subjekti e ka tejkaluar çmimin maksimal të lejuar për produkt të naftës dhe benzinës ku çmimi maksimal i dizelit i përcaktuar

nga ana e Inspektoratit të Tregut ka qenë 1.58 euro, ndërsa si pas kuponëve fiskal nga subjekti është faturuar çmimi 1.62 euro, ndërsa çmimi maksimal i lejuar i benzinës me ligj ka qenë 1.34 euro, ndërsa si pas kuponëve fiskal është faturuar çmimi 1.48 euro. Me te cilin veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 15 të Ligjit për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërishme nr. 08/L-018 të ndëshkuar sipas nenit 19 par. 13 të po këtij Ligji. Andaj, në bazë të dispozitës ligjore të lartshënuar e ka dënuar me dënim me gjobe prej 1.000 (një mijë) €. I pandehuri obligohet që gjobën e shqiptuar dhe shumën prej 5 Euro, në emër të shpenzimeve të procedurës të paguaj në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e Aktgjykimit, a po varësisht nga gjendja ekonomike, mundë të e paguan edhe me 2 këste duke u bazuar në nenin 30 par.1 të Ligjit për kundërvajtje, Nr.05/L-087, në të kundërtën gjoba e shqiptuar dhe shpenzimet e cekura më lartë, do të arkëtohen me dhunë në bazë të dispozitave mbi arkëtimin me dhunë të tatimit, në vështirimin të nenit 163 par. 4 të ligjit për Kundërvajtje. I pandehuri po ashtu, obligohet që pas kryerje së pagesës ta njoftoj këtë gjykatë. Shpenzimet e procedurës së kundërvajtjes janë shqiptuar në përputhje me nenin 59 të Ligjit për Kundërvajtje.

Kundër këtij aktgjykimi ka paraqitur ankesë Samir Kurtishaj si pronar i B.I. NTSH. "Edita" me seli në fshatin Greikoc, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ërvajtëse, në të cilën mes tjerash thekson se: në rastin e vendosjes sipas aktgjykimit gjykata e shkallës së parë nuk e ke vërtetuar drejt gjendjen faktike ngase me rastin e seancës dëgjimore gjykatës i është ofruar faktuar për furnizimin nga Exfis si dhe fatura e shitjes dhe se e njëjta nuk e ka kaluar vlerën e paraparë sipas ligjit në vlerë prej 12 cent, çka do të thotë se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë fare me kundërvajtje ashtu siç gabimisht ka konstatuar gjykata e shkallës së parë. I propozon Gjykatës se Apelit - Divizioni i Kundërvajtjes, që ankesën ta aprovoj si të bazuar, dhe aktgjykimin e goditur ta ndryshoi dhe ti shqiptoi vërejtje gjyqësore me kusht që në të ardhmen mos të përsëritet vepra e njëjtë.

Kolegji i kësaj gjykate, duke i vlerësuar thëniet në ankesë, aktgjykimin e goditur si dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoi se ankesa e paraqitur nga i të pandehuri Samir Kurtishaj, nuk është e bazuar andaj edhe refuzohet.

Kolegji konstatoj se gjykata e shkallës së parë, me rastin e zhvillimit të procedurës për veprën kundërvajtëse, në bazë të dëshmisë së dëshmitares inspektore Shkëndije Bajrami - Azizi e cila në tërësi ka mbetur pranë të dhënave të përpiluara në procesverbalin nga vendi i ngjarjes, duke theksuar se me dt. 24.09.2022 ka qenë në kontroll inspektiv në subjektin ekonomik "Edita" në fshatin Greikoc lidhur me verifikimin e çmimit maksimal të lejuar për secilin produkt të naftës të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ nr. 09/2022, për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 02/2022, për rregullimin e çmimeve të produkteve të naftës dhe karburanteve të ripërtërishme dhe masat tjera mbrojtëse dhe ka konstatuar se operatori në fjalë e ka tejkaluar çmimin maksimal të lejuar të produkteve të naftës dhe të benzinës të konstatuara në bazë të kuponëve fiskal të dt. 24.09.2022, ku çmimi maksimal i përcaktuar si pas MINT dizeli ka qenë 1.58 euro, ndërsa si pas kuponit fiskal është faturuar çmimi 1.62 euro, ndërsa çmimi maksimal i lejuar i benzinës ka qenë 1.34 euro, ndërsa si pas kuponëve fiskal është faturuar 1.48 euro. Në procedurën e provave është bërë leximi i të dhënave në procesverbalin e inspektorit të tregut të dt. 24.09.2022 me nr. 00133/22, me të cilin inspektori ka urdhëruar subjektin ekonomik që në afat prej 8 ditësh ta prezantoj licencën për shitjen me pakicë të NDN, faturat për furnizimit për NDN, si dhe dëshmimin për vendosjen e çmimeve të NDN-së. Me vendimin e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, nr. 01/132 të dt. 30.08.2022, subjekti në fjalë është njoftuar lidhur me rregullimin e çmimeve për produktet e naftës në kuptim të dispozitave të nenit 15 par. 2 të Ligjit për Tregtinë me Produktet e Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërishme, gjithashtu subjekti nga ana e MINT është njoftuar për çmimin maksimal të lejuar dhe atë për

produkte të dizelit është 1.58 euro për litër, çmimi maksimal i lejuar i benzinës i lejuar është 1.34 euro për litër, si dhe çmimi maksimal i lejuar i gazit është 0.75 euro për litër, si dhe pjesërisht nga mbrojtja e të pandehurit, gjykata e shkallës së parë me të drejtë gjeti se i pandehuri është fajtor ngase ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë. Me të drejtë gjykata e shkallës së parë pretendimet e të pandehurit se fatura e shitjes dhe se e njëjta nuk e ka kaluar vlerën e paraparë sipas ligjit në vlerë prej 12 cent, çka do të thotë se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë fare me kundërvajtje ashtu siç gabimisht ka konstatuar gjykata e shkallës së parë. Një pretendim të tillë Kolegji Penal i kësaj gjykate e refuzoj si të pa bazuar, ngase kjo është demantuar plotësisht nga provat e lartë cekura dhe drejtë është arsyetuar nga gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e saj.

Kjo gjykatë i vlerësoi sipas detyrës zyrtare dhe konstatoi se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, për të cilat sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, në të nuk ka kundërthënie me vetveten e as me arsyet e tij, është i qartë dhe konkret. Aktgjykimi i kundërshtuar përmban arsyet e duhura mbi të gjitha faktet relevante të kësaj çështje kundërvajtëse. Pra gjykata e shkallës së parë ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë seancës gjyqësore dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta, objektive dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit të Kosovës duke u bazuar në të gjitha këto që u thanë më lart, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se në këtë çështje kundërvajtëse nuk ka mbetur pa u vërtetuar asnjë fakt vendimtar. Gjithashtu, me aktgjykimin e ankimuar nuk është shkelur as ligji procedurës kundërvajtëse. Kjo për faktin se veprimet e të pandehurit i përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës kundërvajtëse për të cilën i njëjti është shpallur përgjegjës, si dhe nuk ekzistojnë rrethanat të cilat e përjashtojnë ndjekjen apo përgjegjësinë kundërvajtëse të pandehurit. Gjithashtu kolegji i kësaj gjykate ka shqyrtuar edhe çështjen përkitazi me vendimin për dënim dhe vlerësoi se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimi të llojit dhe lartësisë së dënimit i ka shqiptuar dënimin duke pas parasysh të gjitha rrethanat konform dispozitës së nenit 35 dhe 31 të LK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit.

Konform të nenit 143 par.1 dhe par. 3 të LK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ka.nr.316/2023, me datë 23.11.2023

ZYRTARJA LIGJORE
Rrezarta Bala

KRYETARI I KOLEGJIT,
Ferit Osmani

ANTETESINE E KOPJES E VERTETON
CHENEGES I KAZINORES SE GJYKATES
TACNOST KOPIJE POTVRDUJE
UKOVODI OC SUDSKE PISARNICE

